Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 02-951
Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 07.10.2026 nxjerrë këtë:

## VENDIM

**1. NUK akreditohet** Qendra për Aftësim Profesional (QAP) – Ferizaj, me adresë në rr. "Liman Reka" nr. 38, Ferizaj, Republika e Kosovës, për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimit të aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

*1.1. "Instalues i Ngrohjes Qendrore", Niveli III i KKK-së.*

**4.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

2. QAP Ferizaj, në rast të riaplikimit për akreditim për zbatimin e NjMP-së, duhet të adresojë rekomandimet e ekipit të ekspertëve, në veçanti sigurimin e stafit profesional të fushës përkatëse, plotësimin e kërkesave për mentorin dhe vlerësuesit, sigurimin e dokumentacionit të vlefshëm për angazhimin e vlerësuesve të jashtëm, si dhe kompletimin dhe sistemimin e pajisjeve të laboratorit në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe të vlerësimit praktik.

Qendra për Aftësim Profesional (QAP) – Ferizaj ka aplikuar për akreditim për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimit ***"Instalues i Ngrohjes Qendrore", Niveli III i KKK-së***. Ekipi i ekspertëve ka shqyrtuar dokumentacionin e aplikimit më datë 04.04.2026 dhe ka realizuar vizitën vlerësuese në institucion më datë 23.04.2026.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi gjatë vizitës, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se QAP Ferizaj disponon me hapësira dhe kapacitete bazë për realizimin e aktiviteteve profesionale, përfshirë punëtorinë për kualifikimin "Instalues i Ngrohjes Qendrore", me sipërfaqe rreth 100 m². Kualifikimi për të cilin është kërkuar akreditimi për NjMP është i validuar dhe i akredituar.

Megjithatë, ekipi i ekspertëve ka konstatuar mangësi substanciale në përmbushjen e kërkesave për personelin profesional të angazhuar në procesin e NjMP-së. Mentori i propozuar nuk posedon kualifikimin profesional të kërkuar për fushën e kualifikimit, ndërsa dy nga vlerësuesit e jashtëm të propozuar nuk kanë profil përkatës me fushën e "Instaluesit të Ngrohjes Qendrore". Vlerësuesi i tretë ka profil përkatës, por institucioni nuk ka dëshmuar dokumentacion të vlefshëm për angazhimin e tij për periudhën e kërkuar.

Pas pranimit dhe shqyrtimit të dëshmive shtesë të dorëzuara nga institucioni, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se mangësitë kryesore të evidentuara, veçanërisht ato që lidhen me mentorin dhe vlerësuesit e NjMP-së, nuk janë adresuar në masën e nevojshme për të dëshmuar përputhshmëri me kërkesat dhe politikat e AKK-së.

Gjithashtu, ekipi i ekspertëve ka evidentuar nevojën për përmirësimin e gjendjes së laboratorit, sistemimin e pajisjeve në përputhje me kërkesat e procesit të vlerësimit praktik dhe përgatitjen e detyrave praktike për secilën listë kontrolli.

Ekipi i ekspertëve ka rekomanduar që QAP Ferizaj, në rast të një aplikimi të ardhshëm, të sigurojë personel profesional të kualifikuar në fushën përkatëse, të plotësojë kërkesat për vlerësuesit e jashtëm, të harmonizojë pajisjet e laboratorit me kërkesat e kualifikimit dhe të përgatisë detyrat praktike për vlerësim.

Duke marrë parasysh të gjeturat e procesit të vlerësimit, dokumentacionin e paraqitur dhe rekomandimin përfundimtar të ekipit të ekspertëve, Këshilli Drejtues i AKK-së vlerëson se QAP Ferizaj **nuk i përmbush kriteret e nevojshme për akreditim për zbatimin e NjMP-së** në kuadër të kualifikimit "Instalues i Ngrohjes Qendrore", Niveli III i KKK-së.

Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike:*** *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD-së së AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

**Vendimi u dërgohet:**

1. Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) – Ferizaj;
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD-së së AKK-së